




# Isai (a.s.): Një Pejgamber i Islamit





## Isai (a.s.) është një Pejgamber



Islami lajmëron se Isai (a.s.) është njëri prej pejgamberëve të Allahut i cili u dërgua te bijtë e Izraelit me një tekst të ri të shenjtë, për ti udhëzuar ata në rrugën e drejtë. Faktikisht, sipas Islamit pranimi i të gjithë pejgamberëve të Allahut dhe të dërguarve të Tij, është kusht i besimit. Në Kur'anin Famëlartë, librin e shenjtë të muslimanëve, thuhet kështu: *“Thuaj (o Muhammed): “Ne besojmë Allahun, atë që na është shpallur neve, atë që i është shpallur Ibrahimit, Ismailit, Is’hakut, Jakubit, Esbatëve (bijve të tij) dhe në atë që i është dhënë Musait, Isait dhe profetëve nga Zoti i tyre. Ne nuk bëjmë asnjë dallim midis tyre dhe Ne vetëm Atij (Allahut) i përulemi.”* [Ali Imran: 84]

Isai (a.s.), sipas Islamit konsiderohet si lajmëtari i ardhjes së Muhammedit (s.a.s.) dhe nga ana e muslimanëve besohet si përgëzues i ardhjes së pejgamberit të fundit. Në fakt, sipas besimit Islam, feja e cila është predikuar nga ana e të gjithë

pejgamberëve, është Islami, kuptimi i të cilit është dorëzimi i sinqertë vetëm ndaj Allahut.

Një ajet tjetër lajmëron se Isai (a.s.) ka ecur në gjurmët e pejgamberëve të mëparshëm, sikurse Musai (a.s.). *“Pas atyre profetëve, Ne dërguam Isain, të birin e Merjemes, si vërtetues të Teuratit që kishte ardhur para tij. Dhe i dhamë atij Inxhilin (Ungjillin), në të cilin ka udhëzim dhe dritë, si përmbushje të asaj që ishte shpallur para tij në Teurat dhe si udhërrëfim e këshillë për ata që i frikësohen Allahut.”* (Maide: 46).

Emri i Isait (a.s.) në Kur'anin Famëlartë përmendet njëzet e pesë herë. Ai përmendet gjithashtu në pesëmbëdhjetë sure të ndryshme me cilësi të larta, si “i biri i Merjemes; mesihu; robi i Allahut; i dërguari i Allahut”, si dhe “fjala e Allahut; shpirt nga Allahu; shenjë (argument) nga Allahu”.

## **Merjemja; ardhja e Isait (a.s.) në dynja nëpërmjet Merjemes**



Islami, Isain (a.s.) dhe nënën e tij Merjemen e konsideron të shenjtë dhe i nderon ata. Shumë prej muslimanëve zgjedhin ti



emërtojnë fëmijët e tyre me emrat Isa dhe Merjem. Në Kur'anin Famëlartë gjendet një sure e quajtur Merjem dhe një tjetër që mban emrin e babait të saj, Imran. Kur'ani Famëlartë pohon se Merjemja, një grua e ndershme dhe e pastër, e ka sjellur në jetë Isain (a.s.) si një mrekulli: *“[Kujto] kur Melekët thanë: “O Merjeme! Allahu të ka zgjedhur, të ka pastruar dhe të ka parapëlqyer ty mbi të gjitha gratë e botës.”* [Ali Imran: 42]

Muslimanët besojnë se Isai (a.s.) ka lindur nga një virgjëreshë e pastër, por lindjen e tij prej një gruaje të virgjër nuk e pranojnë si një argument për shenjtërinë e tij: *“Ajo [Merjemja] tha: “Zoti im! Qysh do të*

*kem unë fëmijë, kur nuk më ka prekur askush?!” – “Kështu – tha [meleku] - Allahu krijon ç’të dojë Vetë. Kur vendos diçka, Ai vetëm thotë për të: “Bëhu!” dhe ajo bëhet.” (Ali Imran: 47). “Rasti i Isait për Allahun është si rasti i Ademit që e krijoi prej baltës e pastaj i tha: “Bëhu!” - dhe ai u bë.” (Ali Imran: 59).*

Rrjedhimisht, rasti i Ademit (a.s.), i cili u krijuar pa nënë e pa baba, është më mrekulli se sa lindja e Isait (a.s.). Kur Merjemja e solli fëmijën te populli i saj, reagimi i tyre ishte: “O Merjeme, ke bërë diçka të turpshme! O motra e Harunit! Babai yt nuk ka qenë njeri i keq, as nëna jote nuk ka qenë grua e shturur.” Ajo bëri me shenjë nga i biri. Ata thanë: “Si t’i flasim ne fëmijës që është në djep?” Ai [Isai në djep] tha: “Unë jam rob i Allahut. Ai më ka dhënë Librin [Inxhilin/Ungjillin], më ka bërë profet dhe më ka bërë të bekuar kudo që të jem. Ai më ka porositur që të fal namaz e të jap zekat sa të jem gjallë dhe që të jem i mirë ndaj nënës sime dhe nuk më ka bërë të ashpër dhe të padëgjueshëm. Le të jetë paqja e shpëtimi mbi mua, në ditën që kam lindur, në ditën që do të vdes dhe në ditën që do të ringjallem!” (Merjem: 27-33).



## **Mrekullitë e Isait (a.s.)**



Isait (a.s.) iu dhanë disa mrekulli nga ana e Allahut, që të ushtronte detyrën e peygamberllëkut. Për mrekullitë e Isait (a.s.) flitet në suren Ali Imran: *“Dhe [Allahu] do ta caktojë atë të Dërguar te bijtë e Israilit (të cilëve do t’u thotë): “Ju kam sjellë prova nga Zoti juaj (që vërtetojnë Profecinë time); bëj për ju diçka prej balte në formë shpendi, fryj në të e me urdhrin e Allahut ajo bëhet shpend i gjallë; shëroj të verbrit e lindur dhe të lebrosurit dhe i ngjall të vdekurit me lejen e Allahut; ju tregoj çfarë hani dhe çfarë ruani në shtëpitë tuaja. Sigurisht që te të gjitha këto ka prova për ju, nëse jeni besimtarë*

*të vërtetë. Dhe [kam ardhur te ju] për t'ju vërtetuar Teuratin, që është para meje dhe që t'ju lejoj disa gjëra që i keni pasur të ndaluara. Ju kam sjellë një provë nga Zoti juaj, prandaj kijeni frikë Allahun dhe bindmuni! Me të vërtetë, Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj, andaj adhurojeni Atë. Kjo është rruga e drejtë!” [Ali Imran: 49-51].*

## **A është Isai (a.s.) Zot apo bir i Zotit?**



Muslimanët nuk e pranojnë Isain (a.s.) as si Zot dhe as si bir të Zotit. Ata e shohin atë, ashtu si të gjithë peygamberët e tjerë, si një njeri normal, i cili u përzgjodh në mënyrë hyjnore, për të përhapur ndër bijtë e Izraelit mesazhin e Allahut. Islami thekson konceptin e Njësimit të Allahut dhe ndalon përshkrimin e ortakëve për Allahun. Në Kur'anin Famëlartë thuhet: *“Krijuesi i qiejve dhe i Tokës, Ai ju ka dhënë bashkëshorte nga vetja juaj për t'ju shumuar, si dhe bagëti në çifte. Asgjë nuk i shëmbëllen Atij. Ai i dëgjon të gjitha dhe i sheh të gjitha.”* [Shura: 11], *“Ai [Allahu] as nuk lind [nuk është baba i dikujt], as nuk është i lindur [nuk është bir i dikujt].”* [Ihlas: 3].



## A u kryqëzua Isai (a.s.) në kryq?



Të krishterët, të cilët besojnë trinitetin e shenjtë, besojnë se Isai (a.s.), për të cilin mendojnë se erdhi në këtë botë dhe u kryqëzua për shkak të gjynaheve tona dhe se më pas u ringjall dhe qëndron në xhennet deri ditën kur do të kthehet përsëri në dynja, është Zot, apo bir i Zotit.

Muslimanët besojnë se Isai (a.s.) nuk ka vdekur në kryq. Allahu e shpëtoi atë, ndërsa personi që u kryqëzua në kryq, ishte dikush tjetër. Në Kur'anin Famëlartë thuhet: *“[I vulosëm zemrat e tyre] edhe për fjalët e tyre: “Ne e vramë Mesihun – Isain, të birin e Merjemes, të dërguarin e Allahut”. Por, ata as e vranë, as e kryqëzuan, por ashtu u është dukur. Ata që nuk u pajtuan për çështjen e tij, me siguri që gjenden në dyshim për të. Ata nuk kanë ditur kurrëgjë për të, por vetëm kanë hamendësuar. Ata, në të vërtetë, nuk e kanë vranë, por, Allahu e ka ngritur pranë Vetes. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijshtëm.”* [Nisa: 157-158].

Në lidhje me shpjegimin e shprehjes *“ata as e vranë, as e kryqëzuan, por ashtu u është dukur”*, në ajetin më sipër, ka mendime të ndryshme. Sipas mendimit të pranuar nga shumica e Muslimanëve, Isai (a.s.) nuk ka

vdekur fare si një njeri normal, por jeton ende në xhennet me trupin e tij të gjallë. Ndërsa sipas mendimit tjetër, Isai (a.s.) ka vdekur por jo duke u kryqëzuar. Ndërsa shprehja “*Allahu e ka ngritur pranë Vetes*” është komentuar që Allahu e ka shpëtuar Isain (a.s.) prej atyre që donin ta vrisnin.

## **A vdiq Isai (a.s.) për gjynahet tona?**



Sipas shumicës së medh’hebeve të krishtera, Ademi (a.s.) dhe Havaja vepruan një gjynah duke kundërshtuar Allahun dhe përgjegjësia e këtij gjynahu ka kaluar ndër breza, prandaj i gjithë njerëzimi është mallkuar me këtë gjynah fillestar. Sipas këtij besimi, nuk do të ketë shpëtim për ata të që nuk besojnë se Allahu ka dërguar birin e tij që të vritet, duke u kryqëzuar në kryq, si shlyerje të këtij gjynahu.

Muslimanët nuk e pranojnë besimin se Isai (a.s.) vdiq që të pastrohen gjynahet tona dhe që ne të na fali Allahu. Përkundër doktrinës së krishterë, e cila thotë se njeriu në natyrën e tij është i keq (për shkak të gjynahut fillestar), Islami predikon se të gjithë njerëzit lindin pa gjynahe, por mund të bëhen gjynahqarë më pas, nëse kryejnë

gjynahe me vetëdije. Andaj sipas Islamit nuk ka gjynah fillestar.

Koncepti i gjynahut në Islam është i tillë që gjynahu i dikujt nuk mund ti kalohet dikujt tjetër, e njëjta gjë vlen edhe për sevapet (shpërblimin e punëve të mira). Duke qenë se Allahu nuk është i padrejtë, secili është përgjegjës vetëm për veprën e tij. Kur'ani Famëlartë sqaron se individët janë njerëz të lirë, të cilët përgjigjen vetëm për veprat e veta. Pra, duke qenë se nuk bëhet fjalë për diçka që quhet gjynah fillestar, nuk ka nevojë as për shpëtim prej diçkaje të tillë.

**Kontakt:**

Kryesia e ështjeve Fetare  
Drejtoria e Përgjithshme e Botimeve Fetare  
Departamenti i Botimeve në Gjuhët e Huaja dhe Dialektet

Diyanet İşleri Başkanlığı  
Dini Yayınlar Genel Müdürlüğü  
Yabancı Dil ve Lehçelerde Yayınlar Daire Başkanlığı

Üniversiteler Mah. Dumlupınar Bulvarı  
No:147/A 06800 Çankaya-ANKARA/TÜRKİYE  
Tel : +90 312 295 72 81  
Fax : +90 312 284 72 88  
e-mail: yabancidiller@diyanet.gov.tr

**H.z. İSA**  
**ARNAVUTÇA**